



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:060149
Datë: 14.08.2023
Numri i dokumentit: 04581872

C.nr.1246/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. G., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. S., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestuese kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar, jashtë seancës, me datë 14.08.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia paditësit B. G., nga Prishtina dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune t'ia paguaj shumën prej 1,230.48€, me kamatë në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë datë 31.03.2021 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit së saj, pranë kësaj gjykate, me datë 31.03.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin e pagave për shpërblim jubilar.

Në padi, ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura, e sistemuar në vendin e punës si Infermiere e përgjithshme. Tutje ka shtuar se, sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, paditëses i takon kompensimi në emër të një page mujore të saj për më tepër se 20 vite përvojë pune. Paditëses asnjëherë nuk i është paguar paga jubilarë ashtu siç i takon. Paditësja me padi ka kërkuar që në emër të 2 (dy) pagave jubilarë t'i paguhet shuma e përgjithshme prej 1,230.48€, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se me Ligjin e Punës 03/L-212 nuk është paraparë kompensimi për shpërblimin jubilar, dhe për këtë shkak e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj kompensimi, duke kërkuar nga gjykata që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me faktin se në Ligjin e Punës nuk është paraparë ky lloj i kompensimit dhe se e paditura nuk ka paraparë linjë të veçante buxhetore për këtë lloj kompensimi. Në këtë rast kontestues, është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës me numër 01-633485 të datës 29.08.2014, dhe vërtetimin e lëshuar nga e paditura nr. 01-127 të datës 12.02.2021, vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune në pozitën Vozitës dhe ka gjithsej 20 vite përvojë

pune. Po ashtu nga lista e pagave, vërtetohet se paditësja ka pagë mujore neto shumën prej 615.24€.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me përvojën e punës dhe pagës bazë, gjykata i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, për shkakun se vërtetimet e të paditurës jepnin këto të dhëna.

Nga provat e ofruara si më lart, konkretisht nga kontrata e punës numër 01-633485 të datës 29.08.2014, dhe vërtetimin e lëshuar nga e paditura nr. 01-127 të datës 12.02.2021, gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune të e paditura dhe ka 20 vite përvojë pune. Megjithatë, të njëjtës nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 2 (dy) pagave bazë, e paraparë me nenin 17 par. 3 pika 2. të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKSSH).

Gjykata duke ju referuar KKSSH, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 par. 3 pika 2, parashihet se Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij. Gjykata vlerësoi se KKSSH është e aplikueshme në rastin konkret, e njëjta ka hyrë në fuqi me 12.06.2018 dhe është në kohëzgjatje për tre vite nga lidhja e saj. Në nenin 17 par. 4 të KKS parashihet se Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur

gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumën si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se ky lloj kompensimi është në kundërshtim me Ligjin e Punës në fuqi, gjykata nuk e mori të bazuar pasi që me po të njëjtin Ligj është përcaktuar se në hierarkinë e zbatimit në mes të Ligjit, Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës, të zbatohet Kontrata Kolektive, si akt i vullnetshëm e palëve kontraktuese, me kusht që kjo kontratë të mos jetë në kundërshtim me Ligjin e Punës, të mos përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj por mund të përmbajnë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me ligj, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe. Ndërsa lidhur me pretendimin se e paditura nuk ka planifikuar linjë buxhetore për këtë lloj kompensimi, gjykata vë në dukje se Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kanë marrë përsipër që për stafin shëndetësor të rregullohen raportet që parashihen me Kontratën Kolektive Sektoriale, andaj gjykata vendosi si në pikën I të këtij dispozitivi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë

përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1246/2021, datë 14.08.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.